



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr 705/7 Prot

Tiranë, më 25.08.2020

Nr 705 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : **Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,**

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "3H" SHPK, në referim të Urdherit të Ekzekutimit Nr.154 date 12.02.2020 i Gjykates Administrative të Shkalles së Parë Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.705 kërkesën e Kreditorit- Dega e Doganes Tirane për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv, Vendimi për rikuperim me force të borxhit doganor me Nr.705 prot date 06.12.2019 i Degës Doganore Tirane, për Debitorin – Subjekti " NATYRAL GAS" sh.p.k NIUS L71919007O dhe administrator Enis Kaba.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin si dhe Njoftimin për deklarim që përmban Urdheri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori: Subjekti " NATYRAL GAS" sh.p.k NIUS L71919007O dhe administrator Enis Kaba, ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e Debitorit: Subjekti " NATYRAL GAS" sh.p.k NIUS L71919007O dhe administrator Enis Kaba, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Për Sherbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve nga:

- Subjekti " NATYRAL GAS" sh.p.k NIUS L719190070 dhe administrator Enis Kaba
2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "3 H" SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI

